



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 763/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Safa - Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur lidhur me apelin e Meliza Haradinaj Stublla, kandidate për deputete nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.763/2021 i datës 05.03.2021, i ushtruar nga Meliza Haradinaj Stublla, kandidate për deputete nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në komunën e Dragashit fshatrat (Zaplluzhë dhe Shajmë).

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.763/2021 nga Meliza Haradinaj Stublla, kandidate për deputete nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me të cilën pretendon se bazuar në dëshmitar në Komunën e Dragashit, fshatrat (Zaplluzhë dhe Shajmë), ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave dhe se votat e saj janë bartur te kandidatët tjerë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Meliza Haradinaj Stublla, kandidate për deputete nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kërkon rinumërim të votave në komunën e Dragashit fshatrat (Zaplluzhë dhe Shajmë).

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.763/2021, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Meliza Haradinaj Stublla, kandidate për deputete nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret. Paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të pretenduara sepse pritjet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankueses nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel. Gjithashtu ankuesja në apel nuk e ka bashkangjitur asnjë nga vendvotimet të cilat pretendon me apel se janë manipuluar votat, e njëjta në apel përmend emrat e fshatrave (Zaplluzhë dhe Shajmë) dhe nuk saktëson ndonjë vendvotim, prandaj një apel të tillë paneli e refuzon në tersi si të pa bazuar.

Në rastin konkret ankuesja nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete, duke mos bashkangjitur as Formularin i Përputhjes së Rezultateve, e as Formularin e Rezultateve të Kandidatëve. Andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apelin e paraqitur nga Meliza Haradinaj Stublla, kandidate për deputete nga subjekti politik AAK, ta refuzon si të pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Meliza Haradinaj Stublla, e subjektit politik AAK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 763/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuesja e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.